

VENDIM
Nr. 16, datë 11.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “P”; 5 pika 1 germa “P”; dhe 8, neni 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, neni 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s” me vendim nr. 21 datë 18.3.2009, i ndryshuar. Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAEA- Energjia e Energjisë Elektrike” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GAEA-Energjia Alternative e Gjellbër” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në gjuhën greke. Sipas nenit 8 pika 3 dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni teknik:

- Neni 9, pika 4/9, germa “a” e plotësuar.

- Neni 9, pika 4/9, germa “b” e paplotësuar.

- Neni 9, pika 4/9, germa “c” e plotësuar.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “GAEA-Energjia Alternative e Gjellbër” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti